Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
 3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
- rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

(a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

(b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

(c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: -----**[OE e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[OE e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Nr.	Kodi / EWC	Lista e kategorise se mbetjeve	Njesia	Sasia	Cmimi njesi	Cmimi total
1	08 03 17*	Mbetje te tjera te distilimit dhe mbetje te tjera te reaksioneve	Lt	80		
2	13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të pa klorinuar me bazë minerale	Lt	80		
3	15 01 01	Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni	kg	50		
4	15 01 02	Mbetje ambalazhi plastike	kg	50		
5	15 01 04	Mbetje ambalazhi metalike	kg	50		
6	15 01 06	Mbetje Ambalazhi	kg	50		
7	15 01 07	Mbetje ambalazhi qelqi	kg	50		
8	15 02	Absorbente, materiale filtrues, copa/rroba fshirëse dhe rroba mbrojtëse	kg	80		
9	15 02 02*	Absorbues, materiale filtri (përfshirë filtrat e vajit që nuk specifikohen ndryshe), leckat e pastrimit, veshje mbrojtëse të ndotura nga substanca të rrezikshme	kg	50		

10	16 01 03	Goma jashte perdorimit	kg	150		
11	16 06 04	Bateritë alkaline (përveç 16 06 03)	kg	20		
12	18 01	Mbetje nga kujdesi shëndetësor për njerëzit	kg	20		
13	20 01 01	Letër dhe karton	kg	500		
14	20 01 39	Plastike	kg	500		
15	20 01 40	Metale	kg	100		
16	20 03 01	Mbetjet e përziera urbane	kg	500		
17	Të tjera të rrezikshme	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të lindin për shkak të urgjencës ose aktiviteteve jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje të rrezikshme pas karakterizimit	kg	20		
18	Të tjera jo të rrezikshme	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të shfaqen për shkak emergjence ose aktivitete jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme pas karakterizimit	kg	20		
Nr.	B. Thirrja për Mobilizim		Njesia	Sasia		
1	Thirrja 1 – Rajoni i FIER-it (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Fierit drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkohej grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)		Mbetje rutine	here	7	
			Mbetje me thirrje	here	2	
2	Thirrja 2 – Rajoni i KORÇËS (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Korçës drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkohej grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)		Mbetje rutine	here	7	
			Mbetje me thirrje	here	2	

3	Thirrja 3 – Rajoni i BERATIT (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Beratit drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkohej grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje me thirrje	here	2		
4	Thirrja 3 – Selia Qendrore TIRANË (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Tiranës drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkohej grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje me thirrje	here	2		
Nr.	C. Shërbime të tjera	Njesia	Sasia			
1	Analiza laboratorike për karakterizimin	here	2			
Çmimi pa tvsh						
Tvsh						
Çmimi me tvsh						

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen të realizohen në çdo mini kontratë që lidhet bazuar në MK do të jenë sipas zërave të përfshirë në këto tabela dhe afati i kryerjes së tyre do të përcaktohet rast pas rasti sipas nevojave të AK.

Nr.	Kodi / EWC	Lista e kategorise se mbetjeve	Njesia	Sasia
1	08 03 17*	Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve	Lt	80
2	13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të pa klorinuar me bazë minerale	Lt	80
3	15 01 01	Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni	kg	50
4	15 01 02	Mbetje ambalazhi plastike	kg	50
5	15 01 04	Mbetje ambalazhi metalike	kg	50
6	15 01 06	Mbetje Ambalazhi	kg	50
7	15 01 07	Mbetje ambalazhi qelqi	kg	50
8	15 02	Absorbente, materiale filtrues, copa/rroba fshirëse dhe rroba mbrojtëse	kg	80
9	15 02 02*	Absorbues, materiale filtri (përfshirë filtrat e vajit që nuk specifikohen ndryshe), leckat e pastrimit, veshje mbrojtëse të ndotura nga substanca të rrezikshme	kg	50
10	16 01 03	Goma jashtë përdorimit	kg	150
11	16 06 04	Bateritë alkaline (përveç 16 06 03)	kg	20
12	18 01	Mbetje nga kujdesi shëndetësor për njerëzit	kg	20
13	20 01 01	Letër dhe karton	kg	500
14	20 01 39	Plastike	kg	500
15	20 01 40	Metale	kg	100

16	20 03 01	Mbetjet e përziera urbane	kg	500
17	Të tjera të rrezikshme	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të lindin për shkak të urgjencës ose aktiviteteve jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje të rrezikshme pas karakterizimit	kg	20
18	Të tjera jo të rrezikshme	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të shfaqen për shkak emergjence ose aktivitete jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme pas karakterizimit	kg	20
Nr.	B. Thirrja për Mobilizim		Njesia	Sasia
1	Thirrja 1 – Rajoni i FIER-it (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Fierit drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkolet grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje rutine	here	7
		Mbetje me thirrje	here	2
2	Thirrja 2 – Rajoni i KORÇËS (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Korçës drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkolet grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje rutine	here	7
		Mbetje me thirrje	here	2
3	Thirrja 3 – Rajoni i BERATIT (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Beratit drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkolet grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje me thirrje	here	2
4	Thirrja 3 – Selia Qendrore TIRANË (për çdo ndërhyrje të kërkuar nga AK për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit në Rajonin e Tiranës drejt destinacioneve përfundimtare. Thirrja nuk lidhet me numrin apo llojin e mbetjeve të grumbulluara. Me një thirrje të vetme mund të kërkolet grumbullimi i më shumë se një kodi mbetjeje.)	Mbetje me thirrje	here	2
Nr.	C. Shërbime të tjera		Njesia	Sasia
1	Analiza laboratorike për karakterizimin		here	2

Afatet e ekzekutimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër deri më 31.12.2026.

Shtojca 8

TERMAT E REFERENCES

1. HYRJJE

AGSco është një ofrues i shërbimit të mirëmbajtjes së Gazsjellësit, që ushtron aktivitetin në kuadrin e Tregut Shqiptar të Gazit . Duke pasur parasysh veçantitë e biznesit dhe shërbimeve që ofrohen nga AGSco, Shoqëria duhet të nënshkruajë një marrëveshje në bazë të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e mbetjeve të integruara , që gjenerohen gjatë aktiviteteve ditore në qendrat e Mirëmbajtjes, për deponimin e mbetjeve të saj.

2. OBJEKTI I SHËRBIMEVE


2.1. Kërkesat e kontratës dhe objekti i aktiviteteve

Kontraktori do të jetë përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

- Largimin e mbetjeve nga ambientet e AGSco
- Transportin e mbetjeve në një impiant /objekt të licencuar për mbetjet
- Marrjen, përpunimin, deponimin/ riciklimin e mbetjeve
- Lëshimin e certifikatave dhe shënimeve të transferimit dhe plotesimin e të gjithë dokumenteve që kërkohen me ligji dhe nga procedurat e AGSco

Aktivitetet do të kryhen sipas parimeve të përcaktuara në kapitullin "Menaxhimi i mbetjeve" të dokumentit AGSco-STD-001 "Standardet e SHSM për Furnizuesit/Kontraktoret". Zbatimi i këtyre parimeve duhet të konsiderohet i detyrueshëm edhe për të gjithë nënkontraktuesit e përfshirë në aktivitetet, duke përfshirë objektet / impiantet e deponimit të mbetjeve.

Aktivitetet mund të kërkohen sipas një skemë rutinë dy mujore dhe/ose sipas thirrjeve në tre vendndodhjet e AGSco. Njesite e AGSco janë (Zyrat qendrore të Tiranës, Qendra e Mirëmbajtjes Korçë, Njesia Fier, Njësia Çorovodë).



2.2. Kategoritë e mbetjeve

Kontraktori do të jetë përgjegjës për transportimin dhe transferimin në objektet përfundimtare të duhura të mbetjeve, për mbetjet e kategorive të mëposhtme:

- Letër dhe karton
- Plastikë
- Metal
- Mbetjet e Përgjithshme Urbane

- Tonerat për printer
- Bateritë e dëmtuara dhe bateritë e harxhuara të pajisjeve;
- Materiale të tjera të rrezikshme dhe jo të rrezikshm

2.3. Shërbimet rutinë / Shërbimet me thirrje

- Shërbimet rutinë (te realizuar nje here ne dy muaj) përfshijnë grumbullimin, dokumentimin, transportimin dhe asgjësimin e kategorive të mëposhtme të mbetjeve:

- Letër dhe karton
 - Plastike
 - Mbetjet e Përziera Urbane

Sipas programit te meposhtem, ku një shërbim rutinë përfshin me shume se nje mbetje.

SHËRBIMET RUTINË			
Qarku/Region	Mbetja	Vendndodhja	
Qarku FIER	Leter	Fier Detachment	
	Plastike	Fier Detachment	
	Mbetje urbane	Fier Detachment	
	Thirrje ne Qarkun e Fierit		
Qarku KORCA	Leter	Korca MC	
	Plastike	Korca MC	
	Mbetje urbane	Korca MC	
	Thirrje ne Qarkun e Korces		
SHËRBIMET ME THIRRJE			
Qarku FIER	Mbetjet në Shtojcën 2	AGSco	Më marrveshje me kompaninë
Qarku KORCA	Mbetjet në Shtojcën 2	AGSco	Më marrveshje me kompaninë
Qarku BERAT	Mbetjet në Shtojcën 2	AGSco	Më marrveshje me kompaninë
Qarku Tirane zyrat HQ	Mbetjet në Shtojcën 2	AGSco	Më marrveshje me kompaninë

Shërbimet me thirrje përfshijne grumbullimin, dokumentimin, transportimin dhe deponimin/ riciklimin të kategorive të mbetjeve në Shtojcën 2. Ky shërbim do të përfshin një tipologji ose tipologji të ngjashme mbetje në një vendndodhje të caktuar dhe do të kryhet në marrveshje me kompaninë.

3. DETYRIMET E KONTRAKTORIT

- Zbaton kërkesat e përcaktuara në Procedurën e Menaxhimit të Mbetjeve të AGSco dhe në legjislacionin kombëtar në fuqi;
- Siguron, përmes një laboratorit të akredituar, shërbimin e karakterizimit të mbetjeve, **kur** kërkohet nga AGSco / ligji;

- Siguron kopje të lejeve ose licencës nga autoritetet kompetente, me ane të cilave ai të marri, transportojnë, përpunojnë dhe azgjesojnë mbetjet, për të gjitha palët e përfshira nëpërmjet një kontrate;
- Siguron, përsa i përket kompetencës së tij, përgatitjen e të gjitha dokumenteve që kërkohen me ligj në lidhje me largimin, transportin dhe azgjesimin e mbetjeve;
- Është përgjegjës për të caktuar Personin Përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (PPSHSP).
- Siguron personel kompetent, kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, të aftë dhe me përvojë për të kryer Shërbimet.
- I Siguron personelit të tyre, veshje mbrojtëse dhe pajisje sigurie në përputhje me standardin HSE të AGSco.
- Siguron kopje të dokumentacionit të mbetjeve (d.m.th. 3 kopje të dokumentit të transferimit të mbetjeve) për çdo mbetje të terhequr nga AGSco duke konfirmuar dorëzimin në destinacionin përfundimtar të mbetjeve.
- Kopje të dokumentit të kthimit të dorëzimit (dokumenti i transferimit), të siguruar nga objekti i deponimit të mbetjeve, me anë të së cilës vërtetohet dërgimi i saktë në objektet e duhura të mbetjeve që krijohen nga aktivitetet.
- Kur kërkohet nga AGSco, secili Transportues i Mbetjeve duhet të sigurojë prova të dokumentuara, me anë të të cilave konfirmohet se automjetet që transportojnë mbetje janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi;
- Kur kërkohet nga AGSco siguron raportin/deklarimin e mbetjeve tek autoritetet.
- Përgatit çertifikatat e deponimit përfundimtar nga objekti i marrjes së mbetjeve tek AGSco;

Kontraktori do të ketë përgjegjësinë për të siguruar që detyrimet e përmendura më lart do të përmbushen gjithashtu në të gjithë zinxhirin e menaxhimit të mbetjeve deri në destinacionin final tek subjektet perkatese.

I gjithë procesi i lëvizjes së mbetjeve nga zonat e përkohshme të depozitimit të mbetjeve ose çfarëdo pike tjetër e grumbullimit të mbetjeve nga transportuesi i mbetjeve shoqërohet me dokumentin për transferimin e mbetjeve, i cili plotësohet sipas klasifikimit/karakterizimit me kodin EWC (Kodi Europian i Mbetjeve) dhe çdo dokumentacion tjetër që kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.

3.1. Karakterizimi i mbetjeve

Kur është e nevojshme, Kontraktori siguron, përmes laboratorëve të akredituar të analizave të një pale të tretë, karakterizimin e saktë të mbetjeve.

Pas kryerjes së analizës, laboratorit i akredituar i palës së tretë lëshon çertifikatat përkatëse, që përmbajnë të paktën:

- Referencën për AGSco ose Qendren e Mirembajtjes që ka gjeneruar mbetjet;
- Kodin Evropian të Katalogut të Mbetjeve (EWC);
- Përshkrimin e zgjeruar të mbetjeve (që nuk kufizohet në emrin zyrtar të EWC);
- Metodën e marrjes së mostrave. Mostrat mund të mblidhen nga:
 - Personeli kompetent i Kontraktorit të shërbimit;
 - Personeli kompetent i laboratorit;
 - Personeli i AGSco. Në një rast të tillë, procedurat e marrjes së mostrave të shërbimeve dakordësohen me laboratorin që do të kryejë analizën dhe Kontraktori i Shërbimit do të lehtësojë procesin.
- Çdo parametër të analizës, metodën e lidhur me analizën, pasigurinë lidhur me matjen dhe vlerën kufi të referencës, aty ku është e pranishme;
- Një deklaratë përfundimtare që duhet të përmbajë:
 - kodin e saktë EWC që do t'i atribuohet mbetjeve në bazë të procesit të prodhimit të treguar nga AGSco;
 - rezultatet e analizave;
 - në rastin e mbetjeve të rrezikshme, kategoritë perkatese të rrezikut;

3.2. Planifikimi i aktiviteteve dhe marrëveshja e niveleve të shërbimeve

Në mënyrë që të mundësohet një ofrim efektiv dhe efikas i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, para fillimit të aktiviteteve, do të mbahet një Takim Fillestar (Kick off KOM) ndërmjet AGSco Kontraktorit të shërbimeve.

Gjatë Takimit “Kick off” KOM:

- Do të diskutohet Plani HSE (Sigurise se shendetit dhe mjedisit) dhe të gjitha procedurat përkatëse (shih kapitujt vijues). Për më tepër, gjatë të njëjtit takim, një Plan i Menaxhimit të Mbetjeve që do t'i bashkangjitet Planit HSE (Sigurise se shendetit dhe mjedisit) duke vendosur:
 - Kategoritë e mbetjeve që konsiderohen të prodhuara në mënyrë rutine/thirrje;
 - Frekuenca dhe vendet e largimit të mbetjeve rutinë;
 - Aspektet operationale për aktivizimin e shërbimit;
 - Marrëveshjet sipas kriterëve specifikë të shërbimit për mbetjet jo-rutinë;
 - Informacioni minimal që përmbahet në faturë.

4. SHSM (SHËNDETI, SIGURIA & MJEDISI)

Kontraktori zbaton të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar, me referencë të veçantë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin Nr. 10.237 datë 18.02.2010 për “Sigurinë dhe Shëndetin, në Punë” i ndryshuar;
- Ligjin shqiptar për zbatimin e Marrëveshjes për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (Rregullorja ADR);
- Kuadrin Ligjor për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011.

Gjithashtu, Kontraktori do të zbatojë:

- Kërkesat e dokumentit "Standardet minimale të SHSM të AGSco për Kontraktoret" që është e zbatueshme për aktivitetet e tij dhe ofrohet së bashku me këtë objekt të shërbimeve.
- Politikat e AGSco:
 - I gjithë personeli i Kontraktorit do të zbatojë rregullat e sjelljes që përcaktohen brenda AGSco përmes planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialeve informative.

Të gjitha procedurat përkatëse do të sigurohen para nënshkrimit të kontratës dhe në çdo rast para hyrjes në vendpunimet operative.

Përveç të gjitha veprimeve që kërkohen për zbatimin e Legjislacionit shqiptar në lidhje me sigurinë e shëndetit dhe mjedisin, Kontraktori i kërkohet të përgatisë para fillimit të aktiviteteve, një plan specifik të SHSM dhe Dokumentin e Vlersimit të Riskut i cili duhet të koordinohet me planin specifik të AGSco, që përmban masat në funksion për të adresuar rreziqet lidhur me shëndetin, sigurinë dhe mjedisin të lidhura me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveçse sa përmendet në AGSco-STD-001, Plani i SHSM-së:

- përcakton veprimet që duhen të merren për të kontrolluar ato rreziqe në një nivel të pranueshëm, me referencë të veçantë për:
 - Shëndetin, sigurinë dhe mjedisin në punë;
 - Sigurinë e transportit rrugor;
 - Sigurinë e fazës së ngarkim / shkarkimit;
- përfshin një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent, të angazhuar në kryerjen e punës;
- përshkruan zbatimin e dispozitave të AGSco në të gjithë zinxhirin e nënkontraktimit;
- përcakton organizimin dhe përgjegjësitë e QHSE-së;
- përcakton menaxhimin e aspekteve mjedisore.

Kontraktori mund t'i kërkohet të monitorojë treguesit kryesorë specifikë të performancës çdo muaj, sipas një modeli që do të jepet para fillimit të aktiviteteve.

Kontraktori duhet të dorëzojë, së bashku me kopjen e listës së personelit, të gjitha certifikatat përkatëse të trajnimit, të lëshuara nga një organ / autoritet / ent kompetent dhe i licencuar, për të gjithë personelin që do të përfshihet në ofrimin e shërbimeve, madje edhe në të gjithë zinxhirin e tij nënkontraktues.

4.1. Automjetet

Të gjitha dispozitat e përgjithshme të përcaktuara nga AGSco-STD-001 janë në funksion.

Automjetet e transportimit të mbetjeve duhet të jenë certifikuar si duhet sipas legjislacionit shqiptar, për të transportuar mbetjet, dhe duhet të jenë:

- të përshtatshme për mbetjet që transportohen
- të pajisur si duhet për të parandaluar rrjedhjet ose derdhjet (madje edhe me kitet e përshtatshme të derdhjes)
- të mbuluara për të parandaluar perhapjen dhe humbjen e mbetjeve gjatë transportit

Të gjitha automjetet duhet të jenë të përshtatshme sipas qëllimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, në veçanti duke iu referuar:

- Kodit Rrugor Shqiptar;
- Ligjit shqiptar për zbatimin e Marrëveshjes për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (Rregullorja ADR);
- Ligjet shqiptare për menaxhimin e mbetjeve.

4.2. Sistemi i menaxhimit të QHSE-së (cilesia, shëndeti, siguria, mjedisi)

Kontraktori duhet të ketë në funksion një sistem të menaxhimit të QHSE-së bazuar në:

- ISO 9001
- ISO 14001
- ISO 45001

Kontraktori duhet të sigurojë kopje të Çertifikatave të vlefshme të lidhura me fushën e shërbimeve që do të ofrohen.

5. OFERTA EKONOMIKE

Kontraktori duhet të përgatise një oferte ekonomike përcaktuese me llogaritje financiare sa më reale dhe të arsyeshme për shërbimet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij qëllimi të shërbimeve në Shtojcën 2.

Çmimi për thirrje duhet të jetë gjithëpërfshirës i:

- Sesioni fillestar informues;
- Largimi i të gjitha mbetjeve nga objektet e AGSco, sipas vendndodhjeve të rajoneve.
- Depozitimi në një objekt/landfill me License/Leje të përshtatshme.
- Menaxhimi i dokumenteve.

Sasite e pritshme të shërbimeve të parashikuara dhe të kërkuara janë vetëm orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i realizuar ato përgjate periudhës së përcaktuar në MK.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë më pak apo më shumë nga volumet e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të Marrëveshjes Kuadër).

Shtojca 9

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

➤ **Marrëveshje bashkëpunimi** ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar **një angazhim me shkrim** të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marrëveshjes kuadër.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë të lëshuar nga QKL me Kod III.2.B për ushtrimin e aktivitetit të transportit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo-te rrezikshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe listën e mbetjeve të përcaktuara në DT.

2.2.6 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të vetëdeklarojë se nëse do të jetë fitues do të paraqesë se bashku me dokumentacionin e ofertës, Tabelën (Lista e menaxhimit të kodeve, bashkelidhur DT, të plotësuara prej tij), si dhe kontratat e vlefshme të lidhura me subjekte të treta, të cilat sigurojnë ciklin e plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve, për listën e mbetjeve të përcaktuar në DT.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë në stafin e vet **minimumi 3 (tre) punonjes** me kualifikimet si më poshtë:

- 2 (dy) shoferë, të pajisur me leje drejtimi të vlefshme për kategoritë përkatëse të mjeteve që përdoren për transportin e mbetjeve. Të paktën njëri prej shoferëve duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi dhe liçencë ADR në fuqi, për drejtimin e mjeteve që transportojnë mbetje të rrezikshme, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes Evropiane për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme (ADR), të njohur dhe të vlefshme në Republikën e Shqipërisë.

- 1 (një) punonjës për të kryer aktivitetet operacionale në funksion të realizimit të shërbimit objekt kontrate.
- 1(një) Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SShP), i cili mund të jetë një nga punonjësit e deklaruar më sipër ose të sigurohet nëpërmjet një kontrate të vlefshme me palë të tretë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, dhe nuk konsiderohet personel shtesë për qëllime të këtij kriteri.

2.2.7.1 *Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë për 1(një) punonjës që do të angazhohet drejtpërdrejt në aktivitetet në terren, dokumentacion provues për trajnimet ndër- gjegjëse të lëshuara nga institucione trajnimi të licencuara ose të autorizuar nga ministria përgjegjëse, konkretisht:*

- i. *Certifikatë trajnimi/dëshmi pjesëmarrje në trajnim për mbrojtjen nga zjarri.*
- ii. *Certifikatë trajnimi për dhënien e ndihmës së parë.*

2.2.7.2 *Certifikatë/vërtetim aftësie për punë e lëshuar nga mjeku kompetent për te tre punonjësit.*

2.2.7.3 *Certifikatë e lëshuar nga institucioni kompetent, për punonjësin e caktuar si përgjegjës ose koordinator për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në përputhje me Ligjin nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 10 te DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara në këtë kriter do të paraqiten nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qira minimalisht mjetet teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Mjetet	Nr. min.	Argumenti teknik për cdo mjet dhe pajisje të kërkuar
1	Mjet teknologjik (Kamion mbledhës) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane. Kapaciteti minimal $\geq 12 \text{ m}^3$	1	Mjeti teknologjik (kamion) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane do të përdoret për mbledhjen e mbetjeve të zyrave dhe urbane nga koshat dhe kontejnerët. Transporton në mënyrë të sigurt mbetjet drejt landfillit, stacionit të transferimit ose impiantit të trajtimit. Mjeti kërkohet me kapacitet minimal 12 m^3 nisur nga sasia e mbetjeve që gjenerohen në qendrat e mirembajtjes si dhe për të reduktuar numrin e udhëtimeve, kostot e transportit dhe rrezikun e aksidenteve rrugore.
2	Mjet transporti për transportin e mbetjeve të riciklueshme. Kapaciteti minimal $\geq 8 \text{ m}^3$	1	Mjeti për transportin e mbetjeve të riciklueshme do të shërbejnë për transportin e materialeve të ndara për riciklim (plastikë, letër, metal, qelq) ruajtjen e cilësisë së materialeve, duke shmangur përzierjen me mbetje të tjera dërgimin e mbetjeve në qendra riciklimi ose impiante përpunimi. Mjeti kërkohet me kapacitet minimal 8 m^3 nisur nga sasia e mbetjeve që gjenerohen në qendrat e mirembajtjes si dhe për të reduktuar numrin e udhëtimeve, kostot e transportit dhe rrezikun e aksidenteve rrugore.
